20222764197

ФОНД ЗА ЗДРАВСТВЕНО ОСИГУРУВАЊЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Në pajtim me nenin 28 dhe nenin 56, paragrafi 1, pika 3 të Ligjit të Sigurimit Shëndetësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 25/2000, 34/2000, 96/2000, 50/2001, 11/2002, 31/2003, 84/2005, 37/2006, 18/2007, 36/2007, 82/2008, 98/2008, 6/2009, 67/2009, 50/2010, 156/2010, 53/2011, 26/2012, 91/2013, 187/2013, 43/2014, 44/2014, 97/2014, 112/2014, 113/2014, 188/2014, 20/2015, 61/2015, 98/2015, 129/2015, 150/2015, 154/2015, 192/2015, 217/2015, 27/2016, 37/2016, 120/2016, 142/2016 dhe 171/2017 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 275/2019, 77/2021 dhe 285/2021), Bordi Drejtues i Fondit të Sigurimit Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mbledhjen e mbajtur më 15.11.2022 miratoi

RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR PËRMBAJTJEN DHE MËNYRËN E REALIZIMIT TË TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE TË SIGURIMIT SHËNDETËSOR TË DETYRUESHËM

Neni 1

Në Rregulloren për përmbajtjen dhe mënyrën e realizimit të të drejtave dhe detyrimeve të sigurimit shëndetësor të detyrueshëm (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 18/2015, 64/2015, 96/2015, 125/2015, 187/2016, 146/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 44/2019, 198/2019, 63/2020, 202/2020, 303/2020 dhe 217/2021), neni 19 ndryshohet siç vijon:

"Mjeku i zgjedhur mund të ndryshohet në rastet e mëposhtme:

1. Ndërprerje e punës së mjekut të zgjedhur;
2. Ndryshimi i vendbanimit, përkatësisht i punës së mjekut të zgjedhur ose të të siguruarit;
3. Ndryshimi i vendbanimit në institucionet për kujdesin e të moshuarve dhe personave të sëmurë dhe në raste të tjera në përputhje me rregulloret për kujdesin social dhe kujdesin e fëmijëve;
4. Me kërkesë të personit të siguruar, por më së shumti dy herë gjatë një viti kalendarik".

Neni 2

Neni 20 ndryshohet siç vijon:

"Zgjedhja e mjekut për të gjithë personat e siguruar bëhet nëpërmjet ueb-portalit të Fondit duke plotësuar një deklaratë elektronike për zgjedhjen e mjekut në formularin e përcaktuar, të nënshkruar në përputhje me Ligjin e të Dhënave në Formë Elektronike dhe me Nënshkrim Elektronik, me të cilin i siguruari kryen njëkohësisht edhe zgjedhjen e mjekut.

Për personat e siguruar që kanë certifikatë digjitale/kartë shëndetësore elektronike, verifikimi i mjekut të zgjedhur bëhet nga i siguruari dhe mjeku i zgjedhur.

Për personat e siguruar që nuk kanë certifikatë digjitale/kartë shëndetësore elektronike, verifikimi i mjekut të zgjedhur kryhet vetëm nga mjeku me nënshkrim digjital me certifikatën e tij digjitale/kartën elektronike të shëndetësore.

Deklarata e shtypur për zgjedhjen e mjekut, e nënshkruar me dorë nga i siguruari dhe mjeku i zgjedhur, ruhet si dëshmi në kartën shëndetësore të personit të siguruar."

Neni 3

Neni 21 ndryshohet siç vijon:

“Ndryshimi i mjekut të zgjedhur, me çregjistrim nga ai i mëparshmi dhe regjistrimi te mjeku i ri, për të gjithë të siguruarit bëhet nëpërmjet ueb-portalit të Fondit duke plotësuar deklaratën për ndryshimin e mjekut në formularin e përshkruar te mjeku i zgjedhur i ri.

Ndryshimi i mjekut të zgjedhur, përkatësisht çregjistrimi nga mjeku i vjetër i zgjedhur dhe regjistrimi te mjeku i ri i zgjedhur për personat e siguruar, bëhet në të njëjtën ditë.

Për personat e siguruar që kanë certifikatë digjitale/kartë shëndetësore elektronike, verifikimi i ndryshimit në zgjedhjen e mjekut kryhet nga i siguruari dhe mjeku i përzgjedhur.

Për personat e siguruar që nuk kanë certifikatë digjitale/kartë shëndetësore elektronike, verifikimi i ndryshimit të bërë të mjekut të zgjedhur e kryhen vetëm mjeku me nënshkrim elektronik dhe certifikatën digjitale/kartën elektronike shëndetësore të tij.

Deklarata e shtypur për ndërrimin e mjekut të zgjedhur, e nënshkruar nga personi i siguruar dhe mjeku i zgjedhur, ruhet si dëshmi në kartën e shëndetësore të personit të siguruar.

Fondi, sipas detyrës zyrtare, do të bëjë çregjistrimin kolektiv të personave të siguruar nga mjeku i zgjedhur në rast të ndërprerjes së punës së mjekut të zgjedhur ose për shkak të zgjidhjes së marrëveshjes me Fondin.

Gjatë ndërrimit të mjekut të zgjedhur, karta e shëndetësore i kalohet mjekut të ri të zgjedhur me kërkesë të personit të siguruar.”

Neni 4

Neni 22 fshihet.

Neni 5

Neni 23 ndryshohet siç vijon:

“Personi i siguruar që nuk ndryshon mjekun e zgjedhur mund të çlajmërohet vetëm nga mjeku i zgjedhur.

Çregjistrimi i mjekut kryhet nëpërmjet ueb-portalit të Fondit duke plotësuar një deklaratë elektronike për çregjistrimin e mjekut në formularin e përshkruar, me të cilin i siguruari kryen njëkohësisht edhe çregjistrimin e mjekut.

Çregjistrimi i mjekut nënshkruhet nga presoni i siguruar dhe mjeku i zgjedhur me certifikatë digjitale/kartë shëndetësore elektronike.

Për personat e siguruar që nuk kanë certifikatë digjitale/kartë shëndetësore elektronike, verifikimi i çjamërimit të bërë nga mjeku i zgjedhur kryhet vetëm nga mjeku me certifikatën e tij digjitale/kartën shëndetëosre elektronike.

Deklarata e shtypur për çregjistrim nga mjeku i zgjedhur, e nënshkruar nga personi i siguruar dhe mjeku i zgjedhur, ruhet si dëshmi në kartonin shëndetësor të personit të siguruar.

Fondi, sipas detyrës zyrtare, mund të çlajmërojë të siguruarin nga mjeku i zgjedhur, pas konstatimit të keqpërdorimit të vetë zgjedhjes”.

Neni 6

Neni 23-a fshihet.

Neni 7

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe do të publikohet pas marrjes së pëlqimit nga ministri i Shëndetësisë.

Бр. 02-17171/10
22.11.2022
Shkup

Bordi drejtues
Kryetari,
Дејан Николовски, d.v.